



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS
SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL



KGJK.nr.426/2021
Datë: 29 dhjetor 2021

KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS (KGJK), në bazë të nenit 108 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenit 7 të Ligjit nr. 06/L-055 për Këshillin Gjyqësor të Kosovës, nenit 12 të Ligjit Nr. 06/L-057 për Përgjegjësinë Disiplinore të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve, në takimin 274-të, të mbajtur më datë 29 dhjetor 2021, merr këtë:

V E N D I M

- I. Ndryshohet dhe plotësohet pika 2 nën pika 1 e dispozitivit të vendimit KGJK.nr.324/2021, të datës 8 nëntor 2021, sa i përket përbërjes së anëtarëve të Panelit Hetimor në lëndën Nr.AD/KGJK/10/2021/GJTHPE-AD/GJTHPE/15/21, ashtu që në vend të kryesuesit të panelit z. Nikola Petronijevic, gjyqtar në Gjykatën Themelore Mitrovicë, kryesues i panelit caktohet Alush Sinani gjyqtar në Gjykatën Themelore Gjilan.
- II. Vendimi hyn në fuqi me datë 29 dhjetor 2021.

A r s y e t i m

Këshilli Gjyqësor i Kosovës me vendimin KGJK.nr.324/2021, të datës 8 nëntor 2021, ka caktuar anëtarët e Panelit Hetimor në lëndën Nr.AD/KGJK/10/2021/GJTHPE-AD/GJTHPE/15/21, për të hetuar shkeljen e supozuar disiplinore sipas nenit 11 të Rregullores 05/2019 për Procedurën Disiplinore të Gjyqtarëve. Paneli është përbërë prej tre (3) gjyqtarëve, të cilët janë zgjedhur me short dhe vijnë nga gjykatat e tjera dhe jo nga gjykata ku shërben gjyqtari që hetohet.

Këshilli, nga z. Nikola Petronijeviq ka pranuar kërkesë për përjashtim nga procedura disiplinore Nr.AD/KGJK/10/2021/GJTHPE-AD/GJTHPE/15/21, me arsyetim se nuk i plotëson kushtet për të procedurat në panelin hetimor.

Në takimin e datës 29 dhjetor 2021, Këshilli ka shqyrtuar dhe analizuar pretendimet e z. Petronijevic, kryesues i panelit hetimor, duke konstatuar se i njëjti duhet të lirohet nga detyra e kryesuesit të panelit hetimor në lëndën e lart cekur. Këshilli me short ka zgjedhur z. Alush Sinani, gjyqtar nga Gjykata Themelore Gjilan kryesues të këtij paneli hetimor.

Andaj, nga se u tha si më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Albert ZOGAJ,
Kryesues i Këshillit Gjyqësor të Kosovës

Kopje e vendimit i dërgohet

- Anëtarëve të panelit;
- Sekretariatit të KGJK-së, si dhe Arkivit.

